

**PKR.nr.121/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – Shadije Gërguri - kryetare e trupit gjykues, zyrtarin ligjorë Arianit Mahmutaj, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha në lëndën penale kundër të akuzuarve R.P., A.O.dhe M.P.për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, D.K.R, PP.nr.7/2018 të dt.08.05.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë verbal e publik, në prezencën e prokurorës së shtetit Ferdane Sylejmani, të akuzuarit R.P. me av.N.R.sipas autorizimit, A.O.me av.S.M.sipas autorizimit dhe M.P.me av.H.P. sipas detyrës zyrtare, me dt: 14.06.2018 mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

**A K T G J Y K I M**

**TË AKUZUARIT**

**R.P.** nga i ati I.1, dhe e ëma Xh., e gjinisë S., i lindur me dt.... nga fsh. Ll. K-P., ku dhe tani jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si vozitës i kamionave, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim nga data 13.01.2018 deri me dt.14.06.2018

**A.O.**nga i ati I.2 dhe e ëma K., e gjinisë U., i lindur me dt: ... në fsh. G. K-P., ku edhe tani jeton, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, tregtar - agjent i shitjes në ‘C.C.’ në P., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim nga data:13.01.2018 deri me datën 14.06.2018.

**M.P.**nga i ati S. dhe e ëma N., e gjinisë M., i lindur më dt: ... në P., ku edhe tani jeton në rr. “S.” pa nr, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim nga data:13.01.2018 deri me datën 14.06.2018.

**JANË FAJTOR**

**SEPSE:** Pa autorizim, me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, kanë poseduar substanca, të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që me datën: 13.01.2018, rreth orës 01:00, në Prishtinë në rr. "L.P.", policia duke vepruar në bazë të planit operativ, ka ndalur për kontrollë veturën e markës 'Opell Corsa', me ngjyrë të zezë, me targa ..., të cilën e drejtonte i pandehuri R.P., në të njëjtën si pasagjer ishin edhe të pandehurit A.O.dhe M.P., dhe gjatë kontrollit të personave të pandehurit A.O., në rroba iu është gjetur një qese me substanca narkotike, e llojit marihuanë, me peshë prej 38 gram si dhe 3 fishek të kalibrit të panjohur, ndërsa pas kontrollimit të veturës në bagazhin e saj është gjetur një thes i najlonit me substancë narkotike me peshë prej 1 kg 233 gramësh (1 kg e 233 gram) të cilat dëshmi si dhe vetura janë konfiskuar nga ana e policisë,

- Me këtë kanë kryer veprën penale: Blerja, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave narkotike, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 2,3,7,17,21,31,41,47,62,73,74,75,76 dhe 83 të KPRK-së dhe neneve 365 dhe 450 të KPPRK-së.

Të akuzuarit **R.P.**, i shqiptoi **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **2.000 (dymijë) euro** dhe **DENIM ME BURGIM** në kohëzgjatje **prej 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin denim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data:13.01.2018 deri me datën 14.06.2018.

Konform nenit 47 të KPRK-së, me pelqimin e të akuzuarit, pjesa e mbetur e denimit me burgim prej **1 (nje) muaji** zëvendësohet me denim me gjobë, ashtu që 20 € (euro), të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim, e që është **600 € (gjashtëqind) euro**.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, gjykata këtë denim me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu konform nenit 46 par. 3 te KPRK-se, ashtu që 20 € (euro), të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

Të akuzuarit **A.O.**, i shqiptoi **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **2.000 (dymijë) € euro** dhe **DENIM ME BURGIM** në kohëzgjatje **prej 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin denim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data:13.01.2018 deri më datën 14.06.2018.

Konform nenit 47 të KPRK-së, me pelqimin e të akuzuarit, pjesa e mbetur e denimit me burgim prej **1 (një) muaji** zëvendësohet me denim me gjobë, ashtu që 20 € (euro), të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim e që është **600 € (gjashtëqind) euro**.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, gjykata këtë denim me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu konform nenit 46 par. 3 te KPRK-se, ashtu që 20 € (euro), të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

Të akuzuarit **M.P.**, i shqiptoi **DENIM MË GJOBË** në shumë prej **2.000 (dymijë) euro** dhe **DENIM ME BURGIM** në kohëzgjatje **prej 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data:13.01.2018 deri me datën 14.06.2018.

Konform nenit 47 të KPRK-së, me pelqimin e të akuzuarit, pjesa e mbetur e denimit me burgim prej **1 muaji** zëvendësohet me denim me gjobë, ashtu qe 20 € ( euro), të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim e që është **600 € (gjashtëqind) euro.**

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, gjykata këtë denim me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu konform nenit 46 par. 3 te KPRK-se, ashtu qe 20 € (euro), të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim

Konform nenit 62 parg 2 nënparg 2.7 të KPRK-së të akuzuarëve R.P., A.O.dhe M.P.konfiskohet një thes me substancë narkotike në peshë prej **1 (një) kilogram e 233 (dyqind e tridhjet e tre) gram dhe 1 (një) qese me marihuanë në peshë prej 38 (tridhjet e tetë) gram** si dhe 3 fishek të kalibrit të panjohur, dhe të njejtat duhet të asgjësohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit R.P., A.O.dhe M.P.obligohen të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 € (njëqind) euro secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzë PP.nr.7/2018 të dt.08.05.2018, kundër të akuzuarve R.P., A.O.dhe M.P.për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin e dytë me datën 13.06.2018 dhe pasi që të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 246 të KPPK-së kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë dhe pasi i'u ipet mundësia që të pranojnë ose jo fajësinë lidhur me veprën penale që i'u vihet barrë, të akuzuarit në kuptim të nenit 248 të KPPK-së deklarojnë se e pranojnë fajësinë. Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarve mori parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e thellë për kryerjen e veprës penale si dhe premtimin se në të ardhmën nuk do të përsërisin vepra penal, si rrethanë veqanarisht lehtësues që i mundësoj gjykata që të njëjtëve të ju shqipëtoj denimin nën minimumin e paraparë për këtë veprë penale, pastaj si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur moshën e të njëjtteve relativisht të re, se me parë nuk ka qenë të dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale, ndërsa që për të akuzuarin R.P. si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin që është familjar, baba i dy fëmijëve, për të akuzuarin M.P.faktin është i një gjendje të dobët

ekonomike. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njejtit i shpalli fajtorë dhe i gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i aplikuar dispozitat ligjore për zbutjen e denimit me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njejtë do të shërbej si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmën nuk do të kryejnë vepra penale duke ndikuar kështu në rehabilitimin e tyre.

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPPK-së.

Vendimin mbi konfiskim, gjykata e mori konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPRK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.121/18, dt: 14.06.2018,**

**Bashkëpunëtor profesional**  
**Driton Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.